



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 16.5.2024

Nr: 47

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË VAU- DEJËS, ME  
KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E “PARTISË SOCIALISTE TË  
SHQIPËRISË”, ZJ. MAJLINDA ZEF NDRECA**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 1570 prot., datë 12.3.2024, këshilli i bashkisë Vau-Dejës, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, z. Afrim Xhemal Kapidanja, propozuar nga subjekti zgjedhor Partia Socialiste e Shqipërisë.

Referuar nenit 164, pika 2 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, për këshillin e bashkisë Vau-Dejës, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 8, zj. Majlinda Zef Ndreca.

Me shkresën nr. 925, prot., datë 5.4.2024, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në Këshillin e Bashkisë Vau- Dejës, zj. Majlinda Zef Ndreca, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Në bazë të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet

Data: 16.5.2024 Nr: 47  
Ora: 12:00



“Për plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Vau-Dejës, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë zj. Majlinda Zef Ndreca”

pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumëmemërore, të subjektit Partia Socialiste e Shqipërisë, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër SHK-PS-9891\_1 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit të zj. Majlinda Zef Ndreca, rezulton se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 me shkresën nr. 1049 prot., datë 17.4.2024, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr.1039 prot., datë 17.4.2024, ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për zj. Majlinda Zef Ndreca.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën nr. 4475/1 prot., datë 29.4.2024, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar zj. Majlinda Zef Ndreca, ku konstatohet se kandidati nuk ka ndryshime në përbërësit e gjendjes civile.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 6651/1 prot., datë 25.4.2024, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për zj. Majlinda Zef Ndreca, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Në mbështetje të pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për anëtar zj. Majlinda Zef Ndreca, në këshillin e bashkisë Vau-Dejës, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pikat 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreun V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”

## V E N D O S:

1. Plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Vau-Dejës, me kandidatin nga lista shumëmemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, zj. Majlinda Zef Ndreca,
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**